

# Qëndrueshmëria financiare e RTK-së:

Gjetja e alternativave për financim të transmetuesve publik

## Hyrje

Projektligji për transmetimin publik në Kosovë u miratua në parim në seancën plenare të 29 qershorit 2011. Me 64 vota për, tri abstenime dhe asnjë kundër, Kuvendi dëshmoi se është i interesuar që të ketë një ligj të ri për transmetuesit publik. Megjithatë, pjesa e projektligjit që rregullon mënyrën e financimit të transmetuesit publik ngjalli një debat të gjerë. Një nen jo mirë i sqaruar në këtë projektligj ishte edhe ai për themelimin e një kanali të dytë të RTK-së në gjuhën serbe. Komisioni Evropian e kishte konsideruar kalimin e ligjit për transmetuesin publik me urgjencë të lartë, andaj edhe ishte pritur që ky ligj të dal për miratim në seancën e 29 gushtit 2011. Por, një gjë e tillë nuk ndodhi pasi u konsiderua se ky projektligj kërkon më shumë kohë për përmirësime.

Mënyra e financimit të transmetuesit publik ka qenë e pa qartë që nga themelimi i këtij mediumi. Edhe projektligji në fjalë nuk parasheh një mekanizëm afatgjatë të financimit të RTK-së. Sipas projektligjit RTK do të ketë financim të rregullt nga buxheti i shtetit për një periudhë transitore tre vjeçare, ku për çdo vit do t'i ndahet një buxhet që është 0.7% i të hyrave të Buxhetit të Kosovës, plus të hyrat përmes reklamave komerciale. Por çfarë do të ndodh pas tre vitesh? Projektligji parasheh që pastaj financimi të bëhet përmes parapagimit, taksës së rregullt që do ta paguanin qytetarët. Por në çfarë shume dhe si të do bëhet arkëtimi i taksës nuk specifikohet në projektligj.

RTK asnjëherë nuk ka pasur një mekanizëm afatgjatë të financimit. Fillimisht RTK mbështetej në grante të donatorëve dhe ndarje buxhetore nga Buxheti i Kosovës. Më pas Kuvendi vendosi taksën për parapagim, për grumbullimin e së cilës RTK kontraktoi KEK-un. Kjo mënyrë e grumbullimit i mundësoi RTK-së një qëndrueshmëri të mirë financiare, por doli të jetë kontratë jo e leverdishme për KEK-un, e cila edhe ndërpreu

kontratën. Më 16 tetor 2009, Gjykata Kushtetuese e Kosovës mori vendim<sup>1</sup> për të ndaluar arkëtimin e taksës së RTK përmes faturave të KEK. Pas këtij vendimi, Kuvendi i Kosovës nuk arriti të miratojë ligj të ri për RTK-në dhe nga viti 2010 financimi i RTK-së bëhet përmes financimit direkt nga Buxheti i Kosovës.

Në këtë studim, Instituti GAP synon të analizojë qëndrueshmërinë financiare të RTK-së duke analizuar metodat e kaluara të financimit dhe ato që parasheh Projektligji për Transmetimin Publik në Kosovë. Megjithëse projektligji i ri përmban disa nene diskutabile sikurse ai mbi pronësinë e RTK-së dhe ai mbi kanalin e dytë në gjuhën serbe, analiza jonë është e kufizuar vetëm në metodat e financimit që mund të aplikohen në të ardhmen. Instituti GAP vlerëson se metoda më e mirë për financimin e RTK-së është përmes parapagimit. Në këtë analizë kemi paraqitur edhe disa nga metodat e mundshme për mënyrën e parapagimit të RTK-së.

## Financimi i transmetuesit publik sipas standardeve të BE-së

Sigurimi i financave për transmetuesin publik nuk bëhet vetëm sa për t'ia mundësuar operimin e tij, por edhe për të garuar me televizionet tjera komerciale si në aspektin teknologjik ashtu edhe në kualitetin e programeve. Përderisa transmetuesit komercial sigurojnë financimin ekskluzivisht nga reklamat, për transmetuesin publik duhet gjetur një model efektiv të financimit, e cila ndikon direkt në ruajtjen e pavarësisë institucionale dhe editoriale nga shteti, partitë politike dhe grupe të tjera të interesit komercial. Modeli më i mirë i financimit që siguron ruajtjen e pavarësisë editoriale të transmetuesit publik del të jetë financimi nga ana e qytetarëve dhe jo direkt nga buxheti i shtetit.

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës e kanë për obligim që të adoptojnë një model adekuat, të sigurt dhe transparent për financimin e transmetuesit publik, model që do të siguronte fonde të mjaftueshme për të përmbushur misionin e tij. Transmetuesi publik duhet të konsultohet për shumën e parapagimit. Deklarata e Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi garantimin e pavarësisë së transmetuesve publik thotë se shtetet anëtare janë të obliguara që të sigurojnë të gjithë mekanizmat ligjor, politik, financiar, teknik dhe të tjerë, në mënyrë që të sigurohet një pavarësi e vërtetë editoriale dhe autonomi institucionale e transmetuesit publik, duke eliminuar çfarëdo rreziku të ndikimit politik apo ekonomik.<sup>2</sup>

<sup>1</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për masë të përkohshme, rasti KI 11/09, Tomë Krasniqi vs. RTK et Al. Vendimi i plotë [http://www.gjk-ks.org/repository/docs/Vendim\\_-\\_Mase\\_e\\_Perkohshme\\_-\\_MP\\_-\\_Rasti\\_KI\\_11-09\\_Tome\\_Krasniqi\\_vs\\_RTk\\_et\\_Al.pdf](http://www.gjk-ks.org/repository/docs/Vendim_-_Mase_e_Perkohshme_-_MP_-_Rasti_KI_11-09_Tome_Krasniqi_vs_RTk_et_Al.pdf).

<sup>2</sup> Deklarata e Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës, më 27 shtator 2006. Më shumë në: [www.ba-malta.org/file.aspx?f=700](http://www.ba-malta.org/file.aspx?f=700)

Sipas një dokumenti të Departamentit Ligjor të Unionit të Transmetuesve Evropian (EBU)<sup>3</sup> metoda e parapagimit është mënyra kryesore e financimit të transmetuesve publik në të gjithë shtetet e Evropës Perëndimore (përveç Spanjës dhe Holandës). Në shumicën e këtyre shteteve, përveç të hyrave nga parapagimi, transmetuesi publik ka edhe të hyra nga burime tjera, sidomos nga reklamimi/sponsorizimi, por vetëm si burime shtesë të financimit. Sipas këtij dokumenti, financimi përmes parapagimit ka disa përparësi krahasuar me financimin nga ana e buxhetit të shtetit:

- Është garanci për sigurimin e pavarësisë editoriale të transmetuesit publik, i cili në të kundërtën duhet të mbështetet në vullnetin e mirë politik të atyre që vendosin për shumën e alokuar të buxhetit të shtetit.
- Të hyrat mund të parashikohen për disa vjet, që është një parakusht esencial për çfarëdo planifikimi afatmesëm apo afatgjatë.
- Kur ekziston parapagimi, transmetuesi publik natyrisht ka të drejtën e vetë-administrimit.
- Parapagimi është një lidhje e rëndësishme psikologjike në mes të qytetarit që paguan dhe transmetuesit publik, i cili pritët që parat e grumbulluara t'i shfrytëzojë ekskluzivisht në interes të qytetarëve (në vend se, për shembull, në interes të qeverisë apo shumicës parlamentare).

Shuma e taksës për transmetuesin publik duhet të përcaktohet me kujdes. EBU thekson se shumën e parapagimit nuk duhet të korrespondojë me atë që politikanët e konsiderojnë si pak a shumë të pranueshme për elektoratin e tyre dhe definitivisht jo në atë që ata e konsiderojnë si shumë që nuk u bën dëm transmetuesve komercial. Përkundrazi, ashtu siç edhe është përmendur në shumë dokumente të Këshillit të Evropës, duhet të sigurohet që të hyrat totale të transmetuesit publik (parapagimi plus të hyrat tjera) përbëjnë një kornizë financiare të përshtatshme dhe të sigurt që i garanton transmetuesit publik mjetet e nevojshme për të përmbushur misionin e tij. Shuma e taksës duhet të jetë fikse për disa vjet dhe çfarëdo rritje e saj duhet të bëhet me vendim të kuvendit e jo të qeverisë.

EBU jep edhe arsyet përse duhet paguar rregullisht taksa për transmetuesin publik. Përveç kategorive që parashihen me ligj që janë të liruar nga pagesa e parapagimit, arsyeja se nuk posedoj televizor apo radio, apo arsyeja tjetër se megjithatë posedoj aparatin por nuk shikoj-dëgjoj asnjëherë transmetuesin publik, nuk duhet të jetë arsye valide për mos pagesë të taksës. Për ekonomistët, transmetuesi publik hyn në kategorinë e *artikujve meritor*, gjëra apo shërbime që janë vitale për shoqërinë por të cilat tregu vet nuk mund t'i prodhojë apo t'i mbajë. Në këtë kategori hyjnë edhe spitalet, shkollat, policia, etj. Të gjithë qytetarët duhet të kontribuojnë në financim, edhe nëse individualisht nuk përfitojnë asgjë. Si rrjedhojë vetë prezenca e programeve të transmetuesit publik është në interes të shoqërisë si tërësi.

<sup>3</sup> *Broadcast receiving licence fee*, Legal Department, EBU 2006, [http://www.ebu.ch/CMSImages/en/leg\\_p\\_broadcastreceiving%20licencefee\\_011106rev\\_tcm6-50157.pdf](http://www.ebu.ch/CMSImages/en/leg_p_broadcastreceiving%20licencefee_011106rev_tcm6-50157.pdf)

Problemi me metodën e parapagimit është se kërkohet të ketë një agjent grumbullues të taksës për transmetuesin publik. Problem tjetër është se edhe pse shuma e taksës përcaktohet nga institucionet shtetërore, nuk ka ndonjë dallim në mes të të hyrave për familje. Duke qenë një shumë fikse, kjo paraqet një ngarkesë më tepër për familjet më të varfra.

## Historiku i funksionimit dhe financimit të RTK-së

Më 19 qershor 1999, Radio Televizioni i Kosovës (RTK) filloi transmetimin e parë me një program prej dy-orësh. Që nga ajo kohë, RTK ka kaluar nëpër një proces të gjatë të ndërtimit, stabilizimit financiar dhe transferimit nga menaxhmenti ndërkombëtar në atë vendor. Sot, RTK përfaqëson njërin ndër institucionet më të rëndësishme informative, një medium publik pavarësia editoriale e të cilit është dhe do të jetë esenciale për ruajtjen e stabilitetit dhe qëndrueshmërisë së marrëdhënieve ndëretnike si dhe zhvillimin e shëndoshë të skenës politike dhe ekonomike të Kosovës.

Fillimisht RTK menaxhohej nga EBU sipas një memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar në mes të OSBE dhe EBU, memorandum i cili parashihte krijimin e një transmetuesi publik të qëndrueshëm dhe të pavarur. Me kohë, programi i RTK-së shkon duke u zgjeruar nga dy orë program në katër, pastaj në 15 orë program në ditë dhe përfundimisht më 22 dhjetor 2003 RTK fillon të emetojë program 24 orë në ditë. Edhe llojllojshmëria e programeve ka shkuar duke u rritur vazhdimisht duke lansuar programe të reja në gjuhën shqipe dhe në gjuhën e komuniteteve pakicë. Programet e RTK-së transmetohen përmes valëve satelitore dhe atyre tokësore. Fillimisht buxheti i RTK-së varej prej donacioneve, përderisa në muajin e parë të vitit 2003 u vendos që arkëtimi i të ardhurave për RTK-në të bëhej përmes KEK-ut. Deri më tani shërbimet publike të RTK-së kanë përfshi kanal televiziv (RTK) dhe dy radio (Radio Kosova dhe Radio Blue Sky). Sipas projektligjit të ri, RTK-së do t'i shtohet edhe kanali televiziv në gjuhën serbe.

Baza ligjore për funksionimin dhe financimin e RTK-së:

- Baza e parë ligjore për funksionimin e RTK daton qysh nga gjysma e qershorit 2001 kur UNMIK nxori Rregulloren 2001/13<sup>4</sup>. Sipas kësaj rregullore, RTK i përgjigjet PSSP dhe buxheti i RTK miratohet nga ana e PSSP përmes Autoritetit Qendror Fiskal të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.<sup>5</sup> RTK ishte e obliguar që raportin vjetor ta prezantonte para PSSP-së dhe Këshillit Transitor të Kosovës. RTK përveç që do të vazhdonte të financohej nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, neni 11.2 i Rregullores në fjalë vuri bazat e financimit të RTK përmes parapagimit, mirëpo detajet, procedurat dhe agjenti i arkëtimit u lanë të përcaktohen përmes urdhëresave administrative.

<sup>4</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2001/13 për Themelimin e radiotelevizionit të Kosovës, 15 qershor 2001

<sup>5</sup> Neni 3.3 i Rregullores së UNMIK-ut 2001/13

- Një vit e gjysmë më vonë u nxor urdhëresa administrative (UA nr. 2003/5) përmes së cilës u vendos që arkëtimi i mjeteve për RTK-në të bëhej përmes KEK-ut, ku çdo familje, biznes apo institucion tjetër i Kosovës i cili shfrytëzon shërbimet elektrike të KEK-ut ngarkohet me një shumë prej 3 euro për çdo muaj.<sup>6</sup> Pas katër muajve të hyrjes në fuqi të kësaj urdhërese administrative, u përcaktua edhe agjenti për arkëtim - KEK-u.
- Urdhëresa Administrative e lartpërmendur u zëvendësua me një të re, UA 2003/12, e cila linte hapur mundësinë e përzgjedhjes së agentit të arkëtitimit dhe ngriti shumën nga 3 euro në 3.5 euro.<sup>7</sup> Duke u bazuar në këtë UA, më 18 nëntor 2005, RTK lidhi kontratë me KEK-un për arkëtimin e të hyrave për RTK-në në shumën prej 3.5 euro në muaj për një periudhë 3 vjeçare. Për këtë shërbim KEK-ut do t'i paguhej provizioni në lartësi prej 6% dhe reklamimi falas në RTK për vetëdijesimin e qytetarëve kosovar për sigurinë, pagesën dhe kursimin e rrymës.
- Më 20 janar 2006, Kuvendi i Kosovës nxjerr Ligjin nr. 02/L47 për Radiotelevizionin e Kosovës<sup>8</sup> me të cilin zëvendësohet Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/13 dhe aktet tjera ligjore. Sipas ligjit të ri, përgjegjësia raportuese për shpenzimet financiare të RTK-së kalohet nga PSSP në përgjegjësinë ndaj Kuvendit të Kosovës. Ligji për RTK-në nuk e përjashtonte mundësinë që financimi i RTK të bëhej edhe nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës<sup>9</sup>, por financimi kryesor do të bëhet nga parapagimi prej 3.5 euro. Edhe pse Ligji për RTK-në shfuqizoi Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/13 për themelimin e RTK-së, që nënkupton edhe shfuqizimin e UA nr. 2003/12, kontrata në mes të RTK dhe KEK për arkëtimin e mjeteve financiare nga parapagimi vazhdoi të bazohej në UA nr. 2003/12. Edhe pse Ligji për RTK-në i lironte nga pagesa familjet të cilat marrin asistencë sociale si dhe atë pjesë të territorit ku nuk është i shtrirë rrjeti i RTK, taksën për RTK-në e kanë paguar edhe ata qytetarë që kanë jetuar me asistencë sociale dhe ata të cilët nuk kanë pasur fare mundësi ta shikojnë RTK-në përmes rrjetit tokësor. Tabela në fund të këtij studimi pasqyron shtrirjen e sinjalit tokësor të RTK-së në vitin 2008, kur qytetarët paguanin taksën përmes KEK-ut.
- Kontrata në mes të RTK-së dhe KEK-ut duhej të skadonte më 30 nëntor 2009. Pas kësaj date KEK-u nuk ishte më i interesuar të veprojë si agent arkëtues i RTK-së. Kontrata mes RTK-së dhe KEK-ut u ndërpre përfundimisht. Më 16 tetor 2009 Gjykata Kushtetuese konstaton se pagesa prej 3.5 euro është kundër të drejtave të

<sup>6</sup> Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2003/5 për zbatimin e Rregullores së UNIM-ut nr. 2001/13 për Themelimin e Radiotelevizionit të Kosovës, 5 shkurt 2003

<sup>7</sup> Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2003/12 për zbatimin e Rregullores së UNIM-ut nr. 2001/13 për Themelimin e Radiotelevizionit të Kosovës, 3 qershor 2003

<sup>8</sup> Ky ligj hyri në fuqi pas shpalljes nga ana e PSSP më 11 prill 2006

<sup>9</sup> Neni 19.1 i Ligjit nr. 02/L47 për RTK

qytetarëve të Kosovës dhe cakton masat e përkohshme të zbatimit të nenit 20.1<sup>10</sup> të Ligjit mbi RTK dhe i rekomandon Kuvendit ta rishikojë nenin 20.1 deri më 1 dhjetor 2009. Me 14 qershor 2010 Gjykata e përsëriti masën e përkohshme deri më 1 janar 2011.<sup>11</sup> Kjo lëndë ende mbetet e hapur.

- KEK-u ishte ankuar për dëmet financiare që po i sillte kontrata me RTK-në. KEK-u kishte vazhduar me arkëtimin e pagesës edhe në ato rajone të cilat nuk mbuloheshin nga sinjali i RTK-së përkundër kundërshtimeve të qytetarëve. Për shkak të nivelit jo të mirë të arkëtimit nga pagesa e faturave të rrymës, KEK kishte raportuar për humbje deri në 400.000 euro.<sup>12</sup>

## Buxheti i nevojshëm për operimin e RTK-së

Një transmetues publik si RTK ka nevojë për financim adekuat, jo vetëm sa për të operuar por edhe për të mbetur në garë me kanalet tjera komerciale si në aspektin teknologjik ashtu edhe në cilësinë e programeve. Që nga 1 dhjetori 2009 RTK-ja ka dalë krejtësisht nga parapagimi me vendim të Gjykatës Kushtetuese dhe që atëherë financimi vjen nga Buxheti i Kosovës. Edhe për vitin 2010 të hyrat kryesore të RTK-së kanë qenë nga buxheti i Kosovës e që përbëjnë 85% të të hyrave të përgjithshme të RTK-së. Ndërkaq të hyrat nga marketingu kanë gjeneruar 14% të të hyrave të përgjithshme, dhe 1% janë të ardhura të tjera. Buxheti i përgjithshëm i RTK-së gjatë vitit 2010 ishte 12.305.126 euro<sup>13</sup>, prej të cilave rreth 10.5 milion euro i kishte pranuar nga buxheti i Kosovës, kurse rreth 1.8 milion euro ishin të hyra nga marketingu. Në 2010 RTK kishte mbyllur vitin me rreth 1.1 milion euro suficit.

Tab.1: Të hyrat e RTK-së përgjatë viteve

Viti	Nga parapagimi (KEK)	Nga Buxheti i Kosovës	Nga Marketingu	Të tjera	Gjithsej
2010	0	10.464.000	1.733.817	107.345	12.305.162
2009	7.080.276		2.540.445	164.321	9.785.042
2008	8.652.000		1.493.000	244.000	10.389.000
2007	7.991.363		1.526.519	294.400	9.812.282
2006	7.080.000		1.432.654	325.334	8.837.988

Burimi: Sipas raporteve vjetore të RTK-së dhe atyre të auditorëve të pavarur

<sup>10</sup> Neni 20.1 përcakton shumë e taksës prej 3.5 euro që duhet ta paguajnë qytetarët.

<sup>11</sup> Kronologji e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese mbi RTK-në më shumë në: [http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjk\\_ki\\_11\\_09\\_shq.pdf](http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjk_ki_11_09_shq.pdf)

<sup>12</sup> Ibid.

<sup>13</sup> Raporti Vjetor 2010 i RTK

## Financimi i RTK-së sipas projektligjit për transmetimin publik

Sipas Nenit 4 të projektligjit, themeluesi i Transmetuesit Publik të Kosovës është Kuvendi i Kosovës, i cili mbron autonominë institucionale dhe siguron financim adekuat për realizimin e misionit të shërbimit publik të RTK-së. Ky projektligj parasheh që RTK-së t'i sigurohet financim nga Buxheti i Kosovës për tri vitet e ardhshme dhe pastaj financimi të sigurohet përmes parapagimit. Por, edhe nëse nuk mund të gjendet një formë e mirë e parapagimit, RTK-së nuk do t'i mungojë financimi nga Buxheti i Kosovës ngase këtë e parasheh Neni 25<sup>14</sup>, i cili në njëfarë mënyre ia heq shqetësimin RTK-së se do të mbetet ndonjëherë pa financim. Sipas këtij projektligji RTK do të financohet përmes buxhetit të Kosovës, parapagimit, dhe përmes veprimtarisë së tij ekonomike.

- a) **Financimi nga Buxheti i Kosovës** – Edhe pse parapagimi shihet si metoda afatgjate e financimit të RTK, projektligji parasheh që RTK të financohet fillimisht nga Buxheti i Kosovës. Ndonëse konsiderohet si periudhë transitore, për tri vitet e ardhshme, pra deri në sigurimin e financimit nga parapagimi, çdo vit RTK-së do t'i ndahet 0.7% e të hyrave nga Buxheti i Kosovës duke përfshirë të hyrat nga proceset e privatizimit, të hyrat e njëhershme për Buxhetin e Kosovës dhe të hyrat vetanake të nivelit qendror dhe lokal.<sup>15</sup> Kjo do të thotë se RTK do të ketë financimin e garantuar nga buxheti i Kosovës deri në fund të vitit 2014, nëse Ligji miratohet në fund të këtij viti. Buxheti i Kosovës për vitin 2010 ka qenë 1.46 miliard euro, kurse vetëm të hyrat buxhetore kanë qenë 1.2 miliard euro<sup>16</sup>. Nëse për RTK duhet të ndahet 0.7% e të hyrave prej 1.2 miliard, atëherë RTK do të pranojë nga buxheti i Kosovës të hyra prej 8.4 milion euro. Kjo duke mos llogaritur të hyrat nga burimet tjera përfshirë edhe të hyrat nga marketingu ku për vitin 2010 ishin rreth 1.8 milion euro. Kështu RTK për tri vitet e ardhshme do të ketë një buxhet të përafërt me vitet e kaluara, që nënkupton se do t'i mjaftojë për një funksionim standard.
- b) **Parapagimi** – brenda periudhës tre vjeçare kur RTK do të ketë të siguruar financimin, bordi i RTK-së duhet t'i dërgojë Kuvendit propozimin për mënyrën e parapagimit për transmetuesin publik. Ky propozim duhet të miratohet nga Kuvendi. Sipas Nenit 24, Bordi i RTK-së duhet të propozojë për shumën e taksës të cilën do ta paguajnë qytetarët, taksë e cila do të jetë fikse për një periudhë të paktën tre vjeçare. Parapagimin për transmetuesin publik janë të obliguar ta paguajnë të gjithë ekonomitë familjare dhe subjektet juridike, me përjashtim të familjeve që janë shfrytëzues të ndihmave

<sup>14</sup> Neni 25 i Projektligjit për RTK: 'Për sigurimin e bazave të veprimtarisë së pacenuar, aktiviteteve të rregullta dhe pavarësisë editoriale të RTK, si institucion i pavarur publik, themeluesi në varësi të mundësive buxhetore siguron mjete financiare'.

<sup>15</sup> Neni 23, pika 3 e Projektligjit për Transmetimin Publik

<sup>16</sup> Raporti Vjetor Financiar 2010, Ministria e Financave

sociale dhe të pensioneve të luftës së UÇK-së. Përjashtim bëjnë edhe objektet religjioze dhe ato vendbanime ku mungon sinjali tokësor televiziv. Ndërkaq, për mënyrën e realizimit për parapagimin e taksës për RTK duhet të vendosë Bordi i RTK-së, i cili më pas përzgjedh subjektin ekonomik arkëtues pas shpalljes së konkursit publik. Në vitet e kaluara arkëtar i taksës për RTK ka qenë KEK-u, në bazë të kontratës së nënshkruar në mes të dy palëve. Duhet përmendur se edhe me ligjin aktual për RTK-në thuhet se familjet që jetojnë nëpër vendbanime ku mungon sinjali cilësor televiziv duhet të lirohen nga pagesa e parapagimit televiziv, por një gjë e tillë nuk është aplikuar dhe shumë familje që nuk kanë pranuar sinjal televiziv kanë paguar taksën prej 3.5 euro bashkë me faturën e rrymës. Kjo në opinion ka lënë përshtypjen se parapagimi për RTK përmes KEK është një metodë jo e drejtë.

- c) **Burimet tjera** – Sipas projektligjit, RTK-së i lejohej të gjenerojë edhe të ardhura vetanake. Kështu, përveç financimit për tre vite nga Buxheti i Kosovës dhe përveç të ardhurave nga parapagimi që do t'i ketë pas tre vitesh, projektligji i lejon RTK-së që të financohet edhe nga dy burime të tjera. Njëra është vetëfinancimi përmes veprimtarisë së tij ekonomike dhe e dyta përmes burimeve tjera që përfshijnë kontratat me palë të treta për shërbime transmetuese, botimet e prodhimeve muzikore (video, audio, librave, gazetave, revistave), veprimtaritë koncertale, reklammat dhe publikimet e mesazheve tjera të paguara në pajtim me ligjin, sponzorizimet dhe donacionet, përgatitja, prodhimi dhe shitja e programeve të RTK, dhe shërbime të tjera programesh. Sipas këtij projektligji, RTK mund të emetojë reklama nga 10% por jo më shumë se 20% të vëllimit programor të tërësishëm, deri në momentin e financimit nga parapagimi.<sup>17</sup> Kjo do të thotë se RTK mund të reklamojë mesatarisht 6-12 minuta në orë. Kësisoj ligji i jep të drejtën RTK-së të vendos vetë për minutazhin e reklamimit deri në 20% të kohës, duke anashkaluar kështu rolin e Komisionit të Pavarur për Media i cili edhe projektligjin e ri ka autoritetin për kufizimin, minimizimin apo përfundimisht eliminimin e reklamës në subjektin transmetues publik.<sup>18</sup> Minutazha e reklamimit është në kundërshtim me rregullat në fuqi që ka vendosur KPM, ku televizioni publik nuk duhet ta kalojë mesataren e reklamimit ditore prej 6 minutash në orë, kurse për televizionet private limiti është në 12 minuta në orë.<sup>19</sup> Që nga 1 janari 2010 kur ka hy në fuqi kjo Rregullore, KPM ka konstatuar se transmetuesi publik ka shkelur këtë rregullore duke transmetuar reklama më shumë se sa që është e lejuar.<sup>20</sup>

<sup>17</sup> Neni 18 Projekt Ligji për RTK

<sup>18</sup> Neni 21.2 i Projektligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Transmetimin. Edhe ky ligj është pritur të miratohet bashkë me atë për transmetuesin publik në seancën e 29 gushtit 2011, por ngjashëm është tërhequr për shkak se kishte nevojë për më shumë ndërhyrje.

<sup>19</sup> Rregullorja KKPM 2009/04 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, KPM

<sup>20</sup> <http://www.imc-ko.org/index.php?id=786&l=a>



## Si do të financohet RTK pas tre vitesh?

Projektligji për transmetimin publik i garanton financim të rregullt RTK-së për tre vitet e ardhshme. Por projektligji përcakton parapagimin si metodë të financimit afatgjatë. Bazuar në praktikat e shteteve të BE-së, parapagimi është mënyra më e mirë për financimin e transmetuesit publik. Një metodë e tillë, e kryer në mënyrë efikase, jo vetëm që do të ndikonte në ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare të RTK-së, por do të ndihmonte në largimin e dyshimeve për ndërhyrje në pavarësinë editoriale të tij. Bordi i RTK-së do të ketë në dispozicion një periudhë tre vjeçare për të caktuar tarifën e parapagimit, për të përzgjedhur subjektin ekonomik arkëtues dhe mënyrën e arkëtimit të parapagimit. Projektligji në fjalë nuk përmend shumën që duhet paguar, apo mënyrën si do të bëhet pagesa. Është vetë RTK e cila duhet të gjejë mënyrën e grumbullimit të taksës çoftë duke themeluar një organizëm të vetin arkëtues, apo duke kontraktuar një kompani të tretë për të arkëtuar mjetet. Në vazhdim do të prezantojmë disa nga alternativat më të mundshme për arkëtim e taksës për transmetuesin publik, duke paraqitur përparësitë dhe të metat e secilës metodë.

- a) **Parapagimi përmes KEK-ut** - Parapagimi për RTK-në është bërë përmes KEK-ut për gjatë viteve 2003-2009. Kontrata në mes të RTK dhe KEK ka skaduar më 30 nëntor 2009. Edhe pse KEK kishte deklaruar se nuk dëshironte më të jetë inkasant i parapagimit për RTK, megjithatë parapagimi përmes faturave të KEK-ut ende duhet konsideruar si një opsion i mundshëm dhe atë për dy arsye. Së pari, RTK ka qenë në gjendje të mirë financiare gjatë kohës së arkëtimit të taksës përmes KEK, ku mesatarisht ka arkëtuar rreth 8 milion euro në vit. E dyta, KEK ka shtrirjen më të mirë gjeografike në territorin e Kosovës dhe aftësinë më të mirë për të vjelur të hyrat. Mirëpo, për tu bërë kjo e mundshme, është shumë me rëndësi që të bëhet rishikimi i kontratës së kaluar në mes të RTK dhe KEK dhe analizimi me kujdes i arsyeve të dhëna nga ana e KEK për mos vazhdimin e kontratës në mënyrë që të evitohen problemet e njëjta në kontratën e re. Sidomos, nëse mos vazhdimi i kontratës ishte bërë për arsye politike e jo ekonomike atëherë kjo gjithsesi duhet të jetë e kalueshme. Një model i mundshëm mund të jetë që KEK të arkëtojë të ardhurat për RTK, por jo përmes modelit 3.5 euro, por përmes taksës progresive. P.sh. faturës së KEK nga 0-15 euro i shtohet taksa për RTK në shumën 1.5 euro, faturave nga 16-30 euro i shtohet taksa për RTK prej 3 euro, atyre nga 31-50 euro i shtohet taksa prej 4.5 euro, e kështu me radhë. KEK aktualisht ka rreth 400.000 konsumatorë dhe mbulon gjithë territorin e Kosovës. Sigurisht se kontrata e re me KEK do të duhej bërë me pronarët e ri të shpërndarjes dhe furnizimit pasi se kjo pjesë e KEK është në proces të privatizimit. Arkëtimi i taksës së transmetuesit publik përmes korporatave energjetike sot aplikohet nga disa shtete sikurse Shqipëria përmes CEZ Shpërndarjes, Maqedonia, Greqia, etj.
- b) **Përmes telefonisë fikse apo telefonisë mobile** - Një alternativë tjetër për arkëtimin e taksës për RTK-së është që të bëhet përmes

faturave të shërbimeve telefonike. Numri i përgjithshëm i përdoruesve të telefonisë fikse në Kosovë për vitin 2010 ishte 88.377.<sup>21</sup> Edhe pse gjatë vitit 2010 numri i përdoruesve aktiv të telefonisë fikse ka shënuar rritje prej 5.8% krahasuar me numrin e përdoruesve në vitin paraprak, pjesëmarrja e popullsisë në telefoninë fikse nuk është e duhur për të siguruar një pjesëmarrje fer të popullatës për financimin e RTK. Në vendet rurale telefonia fikse nuk ka shtrirje të duhur dhe përveç asaj një numër i madh i telefonisë fikse janë zyrat e institucioneve qeverisëse qendrore dhe lokale. Telefonia mobile mund të jetë një alternativë më e mirë për arkëtimin e parapagimit për RTK. Sipas ART-së numri i përdoruesve të telefonisë mobile për vitin 2010 ishte 1.438.475, që paraqet një rritje prej 19% krahasuar me vitin 2009. Të hyrat e telefonisë mobile për vitin 2010 ishin rreth 182 milion euro. Nëse dëshirojmë që inkasimi i taksës për RTK të bëhet përmes përdoruesve të telefonisë mobile, atëherë për të arritur një financim mesatarisht prej 10 milion euro<sup>22</sup> në vit për RTK-në, 1.45 milion përdoruesit do të duhej të paguanin nga 7 euro në vit, apo 1.7 euro çdo tre muaj. Kjo shumë, njëjtë sikurse pagesa që bëjnë klientet e bankave për mirëmbajtjen e kartelës, do t'ju ndalej përdoruesve të telefonisë mobile gjatë procesit të mbushjes së telefonit me kredi. Kjo metodë e financimit të RTK-së kërkon marrëveshjen e RTK-së me të gjithë operatorët e telefonisë mobile në vend. Metoda e pagesës së taksës për transmetuesin publik përmes faturave të telefonit sot aplikohet nga Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina.

- c) **Përmes Trust-it** – Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti) si institucion që administron dhe menaxhon kontributet e obligueshme pensionale të të punësuarve në Kosovë, mund të shërbejë si agjentë për arkëtimin e taksës për RTK-në. Përparësia e Trustit është se ka një qasje tek shumica e të punësuarve në Kosovë, në sektorin publik dhe privat, të cilët në baza mujore paguajnë kursimet pensionale. Sipas raportit vjetor 2010 të Trustit, gjatë vitit 2010 numri i kontribuuesve në vitin 2010 ishte 234.729. Për shkak të informalitetit të lartë në Kosovë nuk mund të thuhet se ky numër paraqet numrin real të të punësuarve në Kosovë. Por ka një lëvizje pozitive në këtë aspekt sepse numri i kontribuuesve nga viti në vit po rritet, pra ose si pasojë e punësimit të tyre ose për shkak se deklarohen për herë të parë në ekonominë formale. Nëse Trusti do të shërbente si agjent i inkasimit të taksës për RTK, për të arritur një buxhet mesatarisht prej 10 milion euro në vit, 234.729 kontribuuesit e Trustit do të duhej të paguanin nga 3.55 euro në muaj për RTK-në.
- d) **Përmes regjistrimit të veturave** – mënyrë tjetër e arkëtimin të taksës për RTK do të ishte që bashkë me regjistrimin e veturave një herë në vit qytetarët ta paguajnë edhe taksën për transmetuesin publik.

<sup>21</sup> ART raporti vjetor 2010

<sup>22</sup> Shumën prej 10 milion euro e kemi marrë si mostër duke u bazuar në të hyrat e RTK-së për vitin 2010 nga Buxheti i Kosovës. Më këtë shumë nuk aludohet në buxhetin e nevojshëm për operimin e RTK-së në të ardhmen.

Përparësia e kësaj metode është se rrjeti i paguesve do të ishte bukur i shtrirë në tërë territorin e Kosovës. Në vitin 2010 gjithsej 398.215 vetura ishin të regjistruara në territorin e Kosovës dhe për t'i siguruar RTK-së një financim prej 10 milion euro në vit, regjistruarit e veturave do të duhej të paguanin nga 25 euro në vit për taksën e RTK-së. Mesatarja mujore do të ishte 2.1 euro në muaj. Maqedonia, për shembull, arkëton taksën për transmetuesin publik duke taksuar radion e automjeteve.

- e) **Përmes TVSH-së** - kjo do të ishte një metodë tjetër e financimit të RTK-së e cila dallon nga metodat tjera të parapagimit dhe më shumë i përngjan financimit të RTK-së nga buxheti shtetit. Sipas kësaj metode, një përqindje e të hyrave të përgjithshme nga TVSH do të shkonin direkt në një konto të veçantë të RTK-së pa shkuar më parë në konton e buxhetit të shtetit. Në këtë mënyrë kjo metodë e financimit nuk do të mund të konsiderohej si financim nga shteti. Përparësia e kësaj metode është se qytetarët nuk do të ngarkoheshin me një taksë shtesë vjetore të dedikuar enkas për RTK. Të hyrat prej TVSH për vitin 2010 ishin rreth 114 milion euro. Për t'i ndarë RTK-së një buxhet prej 10 milion euro në vit, kjo është e barabartë me rreth 9% të të hyrave të përgjithshme nga TVSH.
- f) **Përmes kabllorëve** - një alternativë jo edhe aq e zakonshme por e mundshme do të ishte që RTK të paguhet nga ana e bartësve të shërbimeve kabllorë në Kosovë. Aktualisht kompanitë që kanë shtrirje më të gjerë të televizionit kabllor janë Ipko, Kujtesa dhe TIK (PTK). Duke qenë se RTK është transmetues publik, këto kompani do të duhej që doemos ta kenë RTK-në në mesin e kanaleve televizive dhe nga të ardhurat e tyre vjetore të ndanin një përqindje për transmetuesin publik. Kësisoj qytetarët duke paguar kompanitë për shërbimin kabllor, në mënyrë indirekte do të paguanin edhe për transmetuesin publik. Kjo sigurisht se nuk do të mjaftonte për t'i siguruar RTK-së buxhetin e duhur vjetor, por do të ishte një alternativë nëse vendosët që RTK të financohet përmes një metode të përzier. Edhe në sistemin e tanishëm shërbuesit kabllor nuk do të duhej ta ndërpresin sinjalin e RTK-së edhe në momentin kur klientit i skadon abonimi.
- g) **Arkëtimi i taksës nga vetë RTK-ja** - sipas kësaj mënyre RTK do të themelonte agjencinë e vet për grumbullimin e taksës për transmetuesin publik. Njëjtë sikurse shërbimet tjera komunale që duhet t'i paguajnë qytetarët ashtu do të paguanin edhe taksën për RTK. Një mënyrë të tillë të grumbullimit të taksës e praktikon Gjermania. Transmetuesi publik i Gjermanisë ka themeluar agjencionin GEZ, që është një organizatë e përbashkët e transmetuesve publik të Gjermanisë ARD, ZDF dhe Deutschlandradio për arkëtimin e taksës për transmetuesin publik.

Secila nga këto modele të lartpërmendura kërkon një studim më specifik për të nxjerrë në pah pengesat e mundshme gjatë zbatimit në praktik. Për shkak të natyrës së studimit dhe për shkak se ky studim është bërë në

kohën kur ligji për transmetimin publik ende nuk është miratuar, është parë më e udhës që vetëm të ofrohen idetë kurse të shtjellohen në detaje në studimet e ardhshme.

Tab.2: Alternativat për financimin e RTK-së

Arkëtari	Rrjeti shtrirës i operatorit	Taksa për individ në muaj	Të hyrat për RTK-në
KEK-u	400.000 konsumator	3 euro*	€14.400.000
Trusti	234.729 kontribuues	3.55 euro	€9.999.455
Telefonisë mobile	1.438.475 përdorues	1.7 euro/ çdo tre muaj	€ 9.781.630
Regjistrimit të veturave	398.215 vetura të regj. në 2010	2.1 euro/muaj (25 euro/vit)	€9.955.375 milion
Përmes TVSh-së	114 milion të hyra nga 2010	9% i të hyrave nga TVSh-ja	€10.260.000 milion

\*Instituti GAP në analizë ka propozuar metodën progresive të faturimit.

## Financimi i televizioneve publike në rajon

Për të pasqyruar sa më mirë pozitën e transmetuesve publik, Instituti GAP ka bërë një hulumtim dytësor për televizionet publike në rajon. Ky pasqyrim i ka ndihmuar këtij hulumtimi të kuptojë më mirë trendet të cilat përcillen rreth mënyrës së financimit të transmetuesve publik në rajon. Ky hulumtim ka përfshirë anën ligjore dhe mënyrën e financimit të transmetuesve publik në Shqipëri, Mal të Zi, Kroaci, Serbi, dhe Maqedoni. Në të gjitha këto vende themelues i transmetuesve publik është vetë shteti.

**Shqipëria** - Radio Televizioni Publik Shqiptar (RTSH) është themeluar në vitin 1999. RTSH duhet të mbulojë së paku 90% të territorit në Shqipëri, kurse të paktën 50% e programeve që transmetohen në RTSH duhet të jetë prodhim i tyre. Sikurse edhe në shumicën e transmetuesve publik edhe në RTSH është e ndaluar propaganda politike, përpos kohës së zgjedhjeve, por edhe gjatë kohës së zgjedhjeve është i ndaluar transmetimi i çdo mesazhi që dëmton politikën e RTSH-së. Reklamat përdorën edhe si një mënyrë e financimit, kurse përpos reklamave RTSH financohet përmes parapagimit. Tarifa e përdorimit të aparaturave radiotelevizive është 600 lekë në vit (4.25 euro). Kjo tarifë llogaritet dhe paguhet nga përdoruesit familjarë vetëm për një marrës televiziv, pavarësisht nga numri i aparateve që kanë në

familje. Për përdoruesit e tjerë jo familjarë kjo tarifë paguhet për çdo aparat televiziv. Me vjeljen e kësaj tarife ngarkohen Zyra e Pagesës së Energjisë Elektrike. Vjelja e kësaj tarife duhet të bëhet brenda tremujorit të parë të çdo viti.<sup>23</sup> Faturat e rrymës elektrike, e bashkë me të edhe tarifa për radiotelevizion mbledhet nga firma CEZ Shpërndarje<sup>24</sup>, e cila për shërbimin e kryer përfiton 10% komision të llogaritur mbi masën e tarifave që ka arkëtuar.<sup>25</sup> Buxheti i shtetit financon shërbimet e radios dhe televizionit për shqiptaret jashtë kufijve të Shqipërisë, shërbimin e radios për publikun e huaj, projekte të rëndësishme teknike për futjen e teknologjisë të re për prodhim dhe transmetim, projekte të mëdha filmike mbarë kombëtare, si dhe orkestrën simfonike të RTSH-së. Masa e financimit përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit të shtetit.<sup>26</sup>

**Kroacia** – Radio-televizioni Publik i Kroacisë është themeluar në vitin 1993 me emrin original Hrvatska Radiotelevizija dhe shkurtesën HRT. Bazuar në principet e realizimit të programeve, HRT-ja duhet të informojë publikun për çështje politike, ekonomike, sociale, kulturore, shëndetësore, edukim, shkencore, religjioze, etj., si dhe të sigurojë diskutim të hapur në të gjitha çështjet me interes për shtetin. Së paku 10% e programeve të transmetuara, përpos programeve informative, manifestimeve sportive, lojërave dhe reklamave, HRT-ja duhet t'i porosis nga kompanitë prodhuese të pavarura. HRT financon nga pagesa e radios dhe televizionit, reklamat, prodhimi dhe shitja e audio-programeve, teleteksti, organizimi i koncerteve dhe manifestimeve tjera.<sup>27</sup> Veç kësaj qytetarët janë të obliguar të paguajnë një shumë për HRT-në e cila është 1.5% e rrogës mesatare mujore të punonjësve në Republikën e Kroacisë, e bazuar në të dhënat statistikore të vitit paraprak.

**Mali i zi** – Radio-televizioni publik malazez është themeluar në vitin 2001, me emrin original Radio Televizija Crne Gore dhe shkurtesën RTCG. Pasuritë e RTCG-së janë pronë shtetërore dhe shteti mban të drejtat dhe obligimet e pronësisë, burimeve të financimit, sigurisë dhe të gjitha të rejave të tjera të prodhimit dhe pronësisë. RTCG-ja nuk mund të privatizohet pa lejen e Parlamentit Malazez. Operimet e biznesit, përveç prodhimit, transmetimit dhe shitjes së programeve, filmave, etj., përfshinë edhe prodhimin dhe transmetimin e reklamave dhe sponsorizimeve. Në marrëveshje me Ligjin e Transmetimit çdo shtëpi private dhe trup legal në territorin e Malit të Zi, i cili pranon së paku transmetimin e një radioje, është i obliguar të paguaj shumë të mëdha mujore prej 3.5 euro për transmetim, shumë kjo e cila paguhet nëpërmjet faturës elektrike.<sup>28</sup> Nëse shuma e

<sup>23</sup> Udhëzimi nr. 1, datë 8.1.2009 Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive

<http://www.qpz.gov.al/doc.jsp?doc=docs/Udhezim%20Nr%201%20Dat%C3%AB%2008-01-2009.htm>

<sup>24</sup> Më shumë rreth CEZ Grup në <http://www.cez.al>

<sup>25</sup> <http://www.qpz.gov.al/doc.jsp?doc=docs/Udhezim%20Nr%2010%20Dat%C3%AB%2023-03-2010.htm>

<sup>26</sup> Ligji Nr. 8410, datë 30.9.1998 / Neni 117/ RTSH

<sup>27</sup> Ligji mbi HRT/ Law on the Croatian Radio-Television/ <http://media.parlament.org.ua>

<sup>28</sup> Ligji për RTCG/ LAW ON PUBLIC BROADCASTING SERVICES "RADIO OF MONTENEGRO" AND "TELEVISION OF MONTENEGRO" <http://www.osce.org/montenegro/19726>

dhuruar nga buxheti i shtetit është e pa mjaftueshme për realizimin e obligimeve të RTCG-së, atëherë këshilli i RTCG-së mund të kërkojë kompensim nga shteti, me kusht që deficitin të mos jetë shkaktuar nga keqpërdorimet e fondit të RTCG-së.

**Serbia** – Radio-televizioni Publik i Serbisë është themeluar në vitin 2001, me emrin original Radio Televizija Srbije dhe shkurtuesën RTS. RTS transmetohet në formën kablo dhe atë satelitor 24 orë në ditë, me qëllim të arritjes më të gjerë të publikut. Financimi i RTS-së bëhet me mbledhjen e një shume nga qytetarët e Republikës së Serbisë e cila bëhet përmes faturave të energjisë elektrike.<sup>29</sup> Sasia e shumës dhe mënyra e mbledhjes janë të përcaktuara sipas ligjit të radio-difuzionit.

**Maqedoni** - Radio televizioni Maqedonas (MRT) është ndërmarrje publike, themeluese i të cilit është Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. Veprimtaria e tij e definuar në mënyrë ligjore përbëhet nga prodhimi dhe emetimi i programit të radios dhe televizionit nga të gjitha zhanret të cilat duhet t'i përmbushin nevojat informative, kulturore, arsimore dhe ato rekreative të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.<sup>30</sup> Financimi i MRT bëhet përmes parapagimit ku secili që posedon një radio apo televizion duhet të paguaj taksën. Shtëpitë paguajnë vetëm një taksë pavarësisht numrit të aparateve që posedojnë. Taksa paguhet për çdo muaj dhe vlera e saj është 2.5% e rrogës mesatare neto në Republikën e Maqedonisë në tre muajt e fundit.<sup>31</sup> Pagesa e taksës bëhet përmes faturës elektrike, përjashtim bëjnë ata që janë deklaruar se nuk posedojnë aparat. Edhe për radion në veturë duhet të paguhet taksë, e cila bëhet një herë në vit me rastin e regjistrimit të veturës.

Tab.3: Financimi i transmetuesve publik në rajon

Shteti	Emri i mediumit	Mënyra e financimit	Inkasanti	Fatura për qytetarin
Shqipëria	TVSh	Parapagim	Taksat për aparat televiziv/fatura e elektrike	600 lekë (2.5 euro)
Mali i Zi	RTCG	Parapagim	Fatura elektrike	3.5 euro në muaj
Kroacia	HRT	Tatim në rrogë	Administrata tatimore	1.5% të rrogës mesatare mujore
Maqedonia	MRT	Parapagim	Fatura elektrike	2.5% të rrogës mesatare mujore
Serbia	RTS	Parapagim	Fatura elektrike	--

<sup>29</sup><http://media.parlament.org.ua>

<sup>30</sup><http://www.mrt.com.mk/al/AL>

<sup>31</sup> Ligji për transmetim publik i Maqedonisë/<http://www.mlrc.org.mk/law/l021.htm>

## Përfundime dhe rekomandime

Që nga themelimi i tij, transmetuesi publik i Kosovës nuk ka pasur një mënyrë të mirë të financimit. Kjo nuk do të thotë se RTK nuk ka pasur një buxhet të mirë për të funksionuar, përkundrazi. Por metodat e financimit kanë qenë kundërthënëse. Metoda e parapagimit përmes KEK ka irrituar shumë qytetarë të cilët është dashur të paguajnë edhe përkundër mungesës së sinjalit, apo për faktin se kanë poseduar dy apo më shumë orë elektrike në shtëpi. Edhe vetë agjenti arkëtues u nda i pa kënaqur nga kjo marrëveshje. Në anën tjetër financimi nga buxheti i shtetit që nga fundi i vitit 2009 e deri më sot, krijon hapësira për ndërhyrje në pavarësinë institucionale dhe editoriale të transmetuesit publik. Transmetuesi publik i Kosovës duhet të gjejë mënyrën më të përshtatshme për të siguruar një financim adekuat në të ardhmen. Mënyra e financimit të RTK duhet të jetë e atillë që garanton një pavarësi institucionale dhe editoriale të RTK-së, si transmetues publik i themeluar për tu shërbyer në mënyrë korrekte të gjithë qytetarëve. Projektligji për transmetuesin publik i siguron financim adekuat vetëm për tri vitet e ardhshme, kështu që ndërkohë duhet të gjendet mënyra për financimin e më tejme të RTK-së. Andaj Instituti GAP sugjeron:

- Parapagimi nga ana e qytetarëve duket se është metoda më e mirë e mundshme për financimin e RTK. Kjo garanton pavarësi editoriale dhe meqë të hyrat mund të parashikohen RTK mund të bëjë planifikime më afatgjate.
- RTK të gjejë modelin më të përshtatshëm të parapagimit dhe agjentit arkëtues dhe më pas t'ia propozojë Kuvendit për miratim. Përcaktimi i shumës së taksës duhet të propozohet nga RTK dhe të miratohet në Kuvend. Marrëveshja me agjentin arkëtues duhet të ndodhë sa më parë në mënyrë që fushata vetëdijësuese për qytetarët të fillojë sa më herët dhe RTK mos të mbetet pa financim në momentin kur mbaron financimi nga buxheti i shtetit.
- RTK duhet ta ri-konsiderojë mundësinë e arkëtimit të taksës përsëri përmes KEK. Kjo metodë është dëshmuar efikase për RTK-në në të kaluarën. Por duhet gjetur një formulë më të mirë të llogaritjes së taksës. Taksa progresive do të ishte një opsion më i pranueshëm se sa taksa fikse për të gjithë.
- Kuvendi është përgjegjës që siguron mbulueshmërinë e territorit të Kosovës me sinjal. Kuvendi duhet t'i ndihmojë RTK-së të përmirësojë infrastrukturën e saj për përçimin e sinjalit dhe të mbulojë të paktën 85% të territorit të Kosovës gjegjësisht 90% të popullatës siç e parasheh ligji.
- RTK duhet të kërkojë nga bartësit e shërbimeve kabllorë televizive që sinjali i RTK të mos ndërpritet edhe atëherë kur klientit i skadon abonimi.

- RTK deri më 2015 duhet të kalojë nga sistemi analog në atë digjital dhe ky tranzicion kërkon mjete shtesë buxhetore. Këto mjete mund të sigurohen nga Qeveria e Kosovës përmes ndarjes së një fondi të veçantë. Kjo me qëllim që të mos shpenzohet përnjëherë buxheti i RTK-së i ndarë nga buxheti i shtetit.
- Kuvendi duhet ta ndryshojë nenin që i lejon RTK-së reklamimin deri në 20% të kohës. Komisioni i Pavarur për Media duhet të gëzojë autoritetin që përcakton kohën e reklamimit për televizionin publik dhe ato komerciale.



Shtojcë: Mbulimi me sinjalin TV tokësor nëpër komunat e Kosovës

KOMUNA	Nr i banorëve <sup>32</sup>	Mbulimi (%) <sup>33</sup>
1. Artanë	6 720	80%
2. Besianë	87 933	95%
3. Burim	39 294	90%
4. Dardanë	35 600	80%
5. Decan	38 984	90%
6. Dragash	33 584	5%
7. Drenas	58 579	10%
8. Ferizaj	108 690	60%
9. Fushë Kosovë	34 718	100%
10. Gjakovë	94 158	95%
11. Gjilan	90 015	95%
12. Kaçanik	33 454	5%
13. Klinë	37 585	70%
14. Leposaviq	-	5%
15. Lipjan	57 474	100%
16. Malishevë	54 664	80%
17. Mitrovicë*	71 601	95%
18. Kastriot	21 548	100%
19. Pejë	95 723	90%
20. Prishtinë	198 214	90%
21. Prizren	178 112	90%
22. Rahovec	55 053	90%
23. Shtërpce	6 913	5%
24. Shtime	27 288	85%
25. Skenderaj	51 317	5%
26. Therandë	59 702	15%
27. Viti	46 959	90%
28. Vushtrri	69 881	95%
29. Zubin Potok	-	5%
30. Zveqan	-	80%
<b>Total</b>	<b>1 733 872</b>	<b>77.73%</b>

<sup>32</sup> Rezultatet paraprake të regjistrimit të popullsisë/ Enti i Statistikave të Kosovës/  
<http://esk.rks-gov.net/rekos2011/?cid=1,40,265>

\*Vetëm një pjesë e kësaj komune nuk është përfshi në regjistrimin 2011

<sup>33</sup> Përqindjet për mbulueshmëri janë marr nga raporti: Tarifat për Shërbimin Publik të transmetimeve – RTK, MARS 2008.



Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

**Instituti për Studime të Avancuara GAP përkrahet nga:**



**Kjo analizë është përkrahur nga:**

